

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR
MBI
PASQYRAT FINANCIARE TË SHOQËRISË

“PROSOUND“ SHPK

PERIUDHA USHTRIMORE

01.01.2020 – 31.12.2020



“ASAMBLESE SË ORTAKËVE”

SHOQËRISË “PROSOUND” shpk, Rruga e Kavajës, ish Misto Mame, zona kadastrale 8240, Tiranë.

TË NDERUAR ZOTËRI!

OPINIONI

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë “**PROSOUND**” shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2020, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë “**PROSOUND**” shpk me datën 31 Dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e pasasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

BAZA PËR OPINIONIN

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Profesionistëve Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (kodi i BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

PËRGJEGJËSITË E DREJTIMIT NË LIDHJE ME PASQYRAT FINANCIARE

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për

GERTA AVRAMI
L51423030F
Nr rregj 348 dt 16.01.2015



të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Ne do të ushtrojmë gjykimin tonë profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit, në pajtim me SNA-të.

Ne do të identifikojmë dhe të vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga mashtrimi apo gabimi, do të hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi në përgjigje ndaj këtyre rreziqeve si dhe, do të marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontrolleve të brendshme.

Ne do të sigurojmë njohjen dhe kuptimin për kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin, në mënyrë që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion lidhur me efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm të entitetit.



Ne do të vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e çmuarjeve (vlerësimeve) kontabël dhe informacioneve shpjeguese përkatëse të dhëna nga drejtimi.

Ne do të arrijmë në një konkluzion lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë nga ana e drejtimit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, do të vlerësojmë nëse ekziston një pasiguri materiale lidhur me ngjarje ose rrethana të cilat mund të hedhin një dyshim të madh për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë. Konkluzionet tona do të bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana të ardhshme mund të bëjnë që entiteti të ndalojë së vijuari veprimtarinë.

TIRANË, 01 MARS 2021

AUDITUES LIGJOR



GERTA AVRAMI

L51423030F

Nr rregj 348 dt 16.01.2015

PASQYRAT FINANCIARE

31 DHJETOR 2020

PROSOUND SHPK

Përmbajtja

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	6
1. Informacion i përgjithshëm	6
2.1 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare	6
2.2 Aktivët afatgjatë materiale	6
2.3 Aktivët dhe detyrimet financiare	7
2.4 Mjete monetare	7
2.5 Transaksionet në monedhë të huaj	7
2.6 Të ardhurat dhe shpenzimet	7
2.7 Tatim fitimi	8
2.8 Detyrimet e pas daljes në pension dhe planet e pensioneve	8
2.9 Inventarët	8
3. Mjetet monetare	8
4. Llogari të arkëtueshme	8
5. Inventari	9
6. Të tjera të arkëtueshme	9
7. Aktive Afatgjatë Materiale	10
8. Të pagueshme ndaj Furnitorëve	11
9. Parapagime dhe të tjera të pagueshme	11
10. Huamarrje	11
11. Detyrime të tjera afatgjatë	12
12. Kapitali	12
13. Shitjet	12
14. Blerje mallrash dhe materialesh	13
15. Shërbime të kontraktuara	13
16. Shpenzime personeli	13
17. Shpenzime administrative dhe të tjera shpenzime	13
18. Të ardhura e shpenzime financiare	14
19. Shpenzimi i Tatim Fitimit	14
20. Ngjarje pas datës së raportimit	14

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shëni me	31 dhjetor 2020 LEKE	31 dhjetor 2019 LEKE
Aktive			
Aktivet afatshkurtra			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	3	9,703,701	1,124,129
Llogari të arkëtueshme	4	28,503,553	35,801,501
Inventari	5	13,451,516	12,191,411
Të tjera të arkëtueshme	6	2,232,067	1,640,490
Parapagim tatim fitimi			-
Shpenzime të shtyra		76,350	
Totali i aktiveve afatshkurtra		53,967,187	50,757,531
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale		83,110,790	106,601,762
Aktive afatgjata materiale të tjera		5,941,866	6,447,871
Totali i Aktiveve Afatgjata	7	89,052,657	113,049,633
Totali i Aktiveve		143,019,845	163,807,164
Detyrimet dhe Kapitali			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	8	3,213,455	5,998,621
Te pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore		380,214	
Te pagueshme për detyrime tatimore		563,791	123,451
Arkitime në avance		1,563,089	2,109,884
Parapagime dhe të tjera të pagueshme	9	12,296,249	9,649,452
Totali i Detyrimeve afatshkurtra		18,016,798	17,881,408
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjatë	10	5,877,988	3,847,484
Llogari të tjera të pagueshme	11	-	10,611,393
Totali i Detyrimeve afatgjata		5,877,988	14,458,877
Kapitali			
Kapitali i paguar		115,649,412	68,400,000
Rezervat për Investime		966,926	966,926
Fitim humbja e pashperndare		-	47,249,412
Fitim/(Humbja) e vitit financiar		2,508,721	14,850,542
Totali i Kapitalit	12	119,125,059	131,466,880
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit		143,019,845	163,807,164

Pasqyrat financiare janë përgatitur dhe miratuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 27 Shkurt 2021, nënshkruar në emër të tij nga:

PROSOUND
Anisa Elbasani
rental@prosound.al
Administrator
www.prosound.al
Blloku i Proveshës, Rr. Mame

Blerina Topa
Shefe Finance

Pasqyra e Performancës

	Shenime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të ardhura nga shitje mallrash		26,150,436	40,145,012
Të ardhura nga shërbimet		51,150,380	89,357,229
Të ardhura të tjera		6,913,784	3,221,514
Total i të ardhurave	13	84,214,599	132,723,755
Materiale të konsumuara	14	(18,733,132)	(29,297,199)
Shërbime të kontraktuara	15	(6,132,492)	(9,772,072)
Përfitimet e punonjësve	16	(19,328,188)	(33,143,573)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	7	(22,549,175)	(24,128,699)
Shpenzimet administrative dhe të tjera	17	(14,619,776)	(18,519,691)
(Humbje) fitim nga operacione		2,851,836	17,862,522
Të ardhura (shpenzime)financiare, neto		235,794	(69,543)
Total të ardhura (shpenzime) financiare, neto	18	235,794	(69,543)
Fitim para tatimit		3,087,630	17,792,979
Tatim fitimi	19	(578,909)	(2,942,437)
Fitimi për vitin		2,508,721	14,850,542

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapital i paguar	Rezerva për investime	Fitimet/(humbjet) e pashpërndara	Totali
Balanca në 01 janar, 2018	68,400,000	966,926	30,550,040	99,916,966
Shpërndarja e fitimeve të pashpërndara				
Fitim/(Humbje) për vitin	-	-	16,699,372	16,699,372
Balanca në 31 dhjetor, 2018	68,400,000	966,926	47,249,412	116,616,338
Balanca në 01 janar, 2019	68,400,000	966,926	47,249,412	116,616,338
Shpërndarja e fitimeve të pashpërndara	-	-	-	-
Fitim/(Humbje) për vitin	-	-	14,850,542	14,850,542
Balanca në 31 dhjetor, 2019	68,400,000	966,926	62,099,955	131,466,880
Balanca në 01 janar, 2020	68,400,000	966,926	62,099,955	131,466,880
Shpërndarja e fitimeve të pashpërndara	47,249,412	-	(47,249,413)	-
Divident			(14,850,542)	(14,850,542)
Fitim/(Humbje) për vitin	-	-	2,508,721	2,508,721
Balanca në 31 dhjetor, 2020	115,649,412	966,926	2,508,721	119,125,059

Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare

Shenime	31 dhjetor 2020 LEK	31 dhjetor 2019 LEK
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti operativ		
Fitimi neto (humbja para tatim fitimit)	3,087,630	17,792,979
Shpenzime per tatimin mbi fitimin jo-monetar	(578,909)	
Zhvlerësim të aktiveve afatgjata materiale	22,549,175	24,128,699
Shpenzime interesi	267,930	380,025
Fitimi (humbja) operative para ndryshimeve në kapitalin punues	25,325,826	42,301,703
Ulje / (rritje) në llogarite e arkëtueshme dhe llogarite e tjera të arkëtueshme	7,999,822	13,356,387
Ulje / (rritje) në inventar	(2,629,907)	(4,839,952)
(Ulje) / rritje në llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme	2,295,262	(8,654,661)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti operativ	32,991,003	42,163,477
Interes i paguar	(267,930)	(380,025)
Tatim fitimi i paguar		(1,766,110)
Flukset neto të mjeteve monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	32,723,073	40,017,342
Flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet e investimit	1,447,801	(41,188,413)
Blerje të aktiveve afatgjata materiale		
Shitje e aktiveve afatgjata materiale		
Mjete monetare neto (te perdorura) ne aktivitetet investuese	1,447,801	(41,188,413)
Flukset e mjeteve monetare nga aktivite financuese	(25,591,302)	(2,250,803)
Rritja neto në mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	8,579,573	(3,421,874)
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre më 1 janar	1,124,128	4,546,003
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor	9,703,701	1,124,128

Shënimet e Pasqyrave Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Prosound shpk “shoqëria” është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më date 06/10/2006.

Selia qendrore e shoqërisë ndodhet në adresën Rruga e Kavajes, ish Misto Mame, Zona Kadastrale 8240, Tirane . Shoqëria është regjistruar si person i tatueshëm në rrethin e Tiranës me NIPT K623200120.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është import-eksport, tregtimin e artikujve të ndryshëm me shumice dhe pakice si: Pajisje të ndryshme të fonise, zerit. Riparim, montim, tregtim të pajisjeve dhe sistemeve audio dhe ndricimit profesional. Vegla muzikore si dhe riparimi i tyre. Dhenia me qera e përdorimit të pajisjeve të ndryshme audio dhe të ndricimit profesional. Organizimi i koncerteve dhe spektakleve të ndryshme me këto pajisje. Administrator i shoqërisë është Znj. Anisa Elbasani.

Më 31 dhjetor 2020 shoqëria ka 24 (njëzet e katër) të punësuar dhe më 31 dhjetor 2019 shoqëria ka 36 (tridhjetë e gjashtë) të punësuar .

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

2.1 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe ligjit Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike dhe parimin e biznesit në vijimësi.

Të dhënat aktuale dhe krahasuese janë shprehur në Lekë shqiptar, që është monedha raportuese e shoqërisë. Disa riklasifikime janë bërë të nevojshme për vlerat krahasuese për të qenë konform prezantimit të vitit aktual.

2.2 Aktivet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale dhe jomateriale janë pasqyruar në librat e shoqërisë me koston e tyre historike minus amortizimin e akumuluar.

Normat vjetore të amortizimit të aplikuara janë si më poshtë:

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Makineri dhe pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Mjete Transporti	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje elektronike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Pajisje zyre	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Makineri dhe Pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Rikonstruksion ndertese	Mbi vlerën kontabël neto	5%

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale rishikohet për rënie në vlerë kur ndryshimet e rrethanave tregojnë që vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse rrethana të tilla ekzistojnë dhe kur vlera kontabël tejkalon vlerën neto të realizueshme, aktivet ose njësitë gjeneruese të parasë do të pakësohen në vlerën e tyre të realizueshme dhe humbjet nga rënia e vlerës njihen nëpasqyrën e performancës (pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve).

2.3 Aktivet dhe detyrimet financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiare konsistojnë tërësisht në llogari të arkëtueshme dhe llogari të pagueshme dhe janë pasqyruar në bilanc bazuar në shumat e faturuara.

Provizionet për borxhet e këqija njihen kur shumat konsiderohen të pambledhshme. Provizioni për borxhet e këqija është vlera e llogaritur nga drejtimi për të absorbuar humbje të mundshme në të ardhmen për llogari të arkëtueshme ekzistuese që mund të bëhen të pambledhshme si pasojë e kushteve ekonomike ekzistuese, rreziqeve të qënësishme dhe të cilësisë së klientëve dhe faktorëve të tjerë relevant, që sigurojnë njohjen aktuale. Vlera e humbjeve specifikisht e identifikuar (psh klientë të klasifikuar si të dyshimtë dhe të humbur) njihen si shpenzime dhe zbriten nga totali i llogarisë së arkëtueshme për atë klient si provizion për borxhet e këqija.

2.4 Mjete monetare

Mjetet monetare përfshijnë para të mbajtura në bankat vendase dhe para në arkë në monedhë vendase dhe të huaj dhe paraqiten me kosto.

2.5 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në Lekë dhe regjistrohen duke përdorur kursin zyrtar në datën e transaksionit. Mjetet monetare dhe zërat e tjerë jomonetare në bilanc të shprehur në monedhë të huaj janë përkthyer në Lekë me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Diferencat e këmbimit që rezultojnë do të kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë.

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhat kryesore për përkthimin e zërave të bilancit të shprehur në monedhë të huaj paraqiten si vijon (në Lekë):

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
1 EUR	123.70	121.77
1 USD	100.84	108.64

2.6 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike do të hyjnë në shoqëri dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ato ndodhin.

2.7 *Tatim fitimi*

Tatimi mbi fitimin është llogaritur në përputhje me legjislacionin shqiptar për tatimin mbi fitimin. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave me përjashtim të zërave që njihen direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Tatim mbi fitimin është tatim fitimi i pritshëm mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat e tatimit në datën e raportimit, dhe cdo korigjim të tatimit të pagueshëm për vitet e kaluara.

Tatim fitimi llogaritet me 15% mbi fitimin e tatueshëm.

2.8 *Detyrimet e pas daljes në pension dhe planet e pensioneve*

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute. Kontributet e shoqërisë në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

2.9 *Inventarët*

Inventarët maten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara që duhen për realizimin e shitjes.

3. Mjetet monetare

Mjetet monetare janë analizuar si vijon:

	2020	2019
Arka	605,014	190,687
-në monedhë vendase	605,014	190,687
Banka	9,098,687	933,442
-në monedhë vendase	6,646,874	469,561
-në monedhë të huaj	2,451,813	463,881
Total	9,703,701	1,124,129

4. Llogari të arkëtueshme

Llogari të arkëtueshme konsistojnë në balancat e fund vitit për shitjet dhe shërbimet e kryera bazuar në shumat e faturuara:

	2020	2019
Klientë	28,503,553	35,801,501
Total	28,503,553	35,801,501

5. Inventari

	2020	2019
Inventar i gatshëm për shitje	13,451.516	12,191,411
Total	13,451.516	12,191,411

6. Të tjera të arkëtueshme

	2020	2019
Tatime të mbipaguara (TF)	736,130	-
Detyrime doganore	126,136	386,534
Parapagime		96,115
Të tjera	1,369,801	1,157,841
Total	2,232,067	1,640,490



7. Aktive Afatgjata Materiale

Aktivitet Afatgjata Materiale janë si vijon:

	Makineri dhe Pajisje	Mjete Transporti dhe Pajisje Të tjera	Pajisje Elektronike	Total
Kosto				
Me 1 janar 2018	115,045,802	16,878,014	7,593,968	139,517,784
Shtesat	38,099,081	8,072,935	1,375,446	47,547,462
Pakesime	5,195,947	1,225,061	0	6,421,008
Me 31 dhjetor 2018	147,948,936	23,725,888	8,969,413	180,644,238
Amortizimi				
Më 1 janar 2018	55,954,923	8,637,032	3,313,557	67,905,512
Amortizimi i vitit	13,410,657	2,136,209	1,201,942	16,748,808
Më 31 dhjetor 2018	69,365,580	10,773,241	4,515,499	84,654,320
Vlera kontabël neto 1 janar 2018	59,090,880	8,240,982	4,280,411	71,612,272
Vlera kontabël neto 31 dhjetor 2018	78,583,357	12,952,647	4,453,914	95,989,918
Kosto				
Me 1 janar 2019	147,948,936	23,725,888	8,969,413	180,644,238
Shtesat	40,106,547	6,119,680	782,017	47,008,244
Pakesime	-5,429,041	-390,790	0	-5,819,831
Me 31 dhjetor 2019	182,626,442	29,454,778	9,751,430	221,832,651
Amortizimi				
Më 1 janar 2019	69,365,580	10,773,241	4,515,499	84,654,320
Amortizimi i vitit	19,714,762	3,127,400	1,286,537	24,128,699
Më 31 dhjetor 2019	89,080,342	13,900,641	5,802,036	108,783,019
Vlera kontabël neto 1 janar 2019	78,583,357	12,952,647	4,453,914	95,989,918
Vlera kontabël neto 31 dhjetor 2019	93,546,101	15,554,137	3,949,394	113,049,633
Kosto				
Me 1 janar 2020	93,546,101	15,554,137	3,949,394	113,049,633
Shtesat	2,161,550	240,421	904,941	3,306,912
Pakesime	(4,500,269)	(238,552)	(15,893)	(4,754,714)
Me 31 dhjetor 2020	91,207,382	15,556,006	4,838,442	111,601,831
Amortizimi				
Më 1 janar 2020				
Amortizimi i vitit	18,336,646	3,098,017	1,114,509	22,549,176
Më 31 dhjetor 2020	18,336,646	3,098,017	1,114,509	22,549,176
Vlera kontabël neto 1 janar 2020	93,546,101	15,554,137	3,949,394	113,049,633
Vlera kontabël neto 31 dhjetor 2020	72,870,736	12,457,989	3,723,933	89,052,658

8. Të pagueshme ndaj Furnitorëve

Një detajim i llogarive të pagueshme jepet si vijon:

	2020	2019
Furnitorë	3,213,455	5,998,621
Total	3,213,455	5,998,621

9. Parapagime dhe të tjera të pagueshme

Të tjera të pagueshme lidhen me arkëtimet e marra në avancë dhe tatime, taksa të pagueshme. Një detajim është si vijon:

	2020	2019
Kontribute për sigurime shoqërore e shëndetësore	380,214	655,715
Tatim mbi te ardhurat personale	86,900	176,112
Tatim në burim	38,851	64,943
Tatimi mbi vleren e shtuar	438,040	607,702
Dividend i pagueshem	12,296,249	3,087,080
Parapagime të tjera	1,563,089	5,057,900
Total	14,803,343	9,772,903

10. Huamarrje

Shoqëria ka lidhur nje kontrate per overdraft prane bankës Raiffeisen Bank Sha , me normë interesi Tribor +2.5 %. Shoqëria ka financuar me qira financiare dy makina sipas kontratave të huase bankare pranë bankës OTP Bank në vlerë 29,567.09 Euro dhe afat për 5 vite dhe kontrate prane bankes Raiffeisen Bank ne vlere 16,030 Euro dhe afat për 5 vite. Shoqëria ka lidhur nje kontrate per Kredi Bankare prane bankës Raiffeisen Bank Sha , me normë interesi 0% per pagimin e punonjesve gjate periudhes se Covid-19 ne vlere 2,257,710 leke .

Huamarrja në 31 dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

	2020 LEK	2019 LEK
Pjesa afatshkurtër:		
Overdraft	-	1,114,330
Leasing	1,068,450	995,554
Kredi Bankare	1,505,207	
	2,573,657	2,109,884
Pjesa afatgjatë:		
Leasing	2,649,666	3,847,484
Kredi Bankare	654,665	
	3,304,331	3,847,484
Total	5,877,988	5,957,368

11. Llogari të tjera të pagueshme

Shoqëria ka detyrime ndaj ortakëve si me poshtë:

	2020	2019
Të pagueshme ndaj ortakëve	-	10,611,393
Total		10,611,393

12. Kapitali

Prosound Shpk është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e cila me date 01 Janar 2020 kishte kapital themeltar 68,400,000 Lekë. Ne date 27 Janar 2020 sipas vendimit të ortakëve nr 2, Z.Kliton Gjika zoturues i kapitalit në masën 100 % ka shitur 10 % të kapitalit Z,Angjello Gjika. Ne date 27 Tetor 2020 sipas vendimit të ortakëve nr 7 u vendos rritja e kapitalit nga fitimi i pashperndare i krijuar nga fitimet e Shoqërisë për të gjitha periudhat para vitit 2019 në shumën 47,249,412 leke, si dhe shpërndarja e fitimit të pashperndare (dividend) të fitimit të krijuar për periudhën financiare të vitit 2019 në shumën 14,850,542 leke. Lëvizje të tjera në kapital janë fitim/humbjet e vitit ushtrimor. Shoqëria zotërohet nga z. Kliton Gjika në masën 90% (104,084,471 leke) dhe z.Angjello Gjika në masë 10% (11,564,941 leke) deri më 31 dhjetor 2020.

13. Të ardhurat nga shitjet

Totali i shitjeve konsiston në shitjen e mallrave dhe aktiveve afatgjata të shoqërisë dhe shërbimeve.

	2020	2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		
Shitje të mallrave	26,150,435	40,145,012
Shitje të shërbimeve	51,150,380	89,357,229
Të ardhura të tjera	6,913,784	3,221,514
Total	84,214,599	132,723,755

Sipas Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur 2020: të ardhurat janë në total 84,214,599 Lekë që përbëhet nga shitje mallrash në vlerën 26,150,380 lekë, shitje shërbimesh në vlerën 51,150,380 lekë dhe nga shitje e aktiveve afatgjata dhe të tjera në vlerën 6,913,784 lekë .

Sipas librave të shitjes për vitin 2020:

Shitje	81,875,448
Paradhënie	2,600,386
Autongarkesë	(441,332)
Total	84,034,502
Zbritje nga furnitori	180,097
Sipas Pasqyrave :	84,214,599

14. Blerje mallrash dhe materialesh

Blerje mallrash dhe materialesh jane detajuar si vijon:

	2020	2019
Kosto e mallit te shitur	18,733,132	29,297,199
	18,733,132	29,297,199

15. Shërbime të kontraktuara

Shpenzimet nga nenkontraktoret jane detajuar si vijon:

	2020	2019
Shërbime nga palë te treta për aktivitetin rental	6,132,492	9,772,072
	6,132,492	9,772,072

16. Shpenzime personeli

Shpenzimet për personelin janë detajuar si vijon:

	2020	2019
Pagat e punonjësve	16,579,950	28,594,291
Kontribute shoqërore e shëndetësore	2,748,238	4,549,282
	19,328,188	33,143,573

17. Shpenzime administrative dhe të tjera shpenzime

Shpenzimet administrative dhe të tjera detajohen si vijon:

	2020	2019
Vlera Kontabel e AAGJ te shitura	4,754,714	
Mirëmbajtje dhe riparime	825,434	2,591,504
Qira	1,323,150	1,544,605
Blerje, energji, avull, uje, karburant	2,170,510	3,020,877
Shpenzime marketingu	55,625	1,127,363
Shpenzime për shërbimet bankare	452,233	671,737
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	515,294	784,094
Shpenzime transporti	132,524	67,512
Shpenzime udhetimi, dieta	57,130	1,237,563
Sigurim, siguracion dhe taksa automjete	604,514	958,144
Taksa dhe tarifa vendore	35,314	96,250
Të tjera shpenzime administrative	3,693,335	6,420,041
Total	14,619,776	18,519,691

18. Të ardhura e shpenzime financiare

Të ardhurat/(shpenzimet) financiare përfshijne fitimet dhe humbjet e realizuara apo të porealizuara nga kurset e këmbimit, të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat, dhe të tjera të ardhura financiare si vijon:

	2020	2019
Shpenzime Interesi		
Të ardhura nga kursi i këmbimit	890,134	668,299
Shpenzime nga kursi i këmbimit	(386,422)	(978,781)
Të ardhura/shpenz financiare te tjera	(267,918)	380,025
Total i të ardhurave/shpenz financiare	(235,794)	69,543

19. Shpenzimi i Tatim Fitimit

Fitimi /Humbja i vitit i paraqitur në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve për vitin 2020 dhe 2019, e cila mbartet në vitin pasardhës, detajohet si vijon:

	2020	2019
Fitim / (Humbja) para tatimit mbi të ardhurat	3,087,630	17,792,979
Shpenzimet e pazbritshme	771,760	1,823,270
Fitim / (Humbja) fiskale	3,859,390	19,616,249
Përqindja e tatimit mbi të ardhurat	15%	15%
Tatimi mbi fitimin	578,909	2,942,437
Shpenzimet e pazbritshme	2020	2019
Gjoha dhe demshperblime	56,226	105,809
Shpenzime dhurata	39,600	222,156
Transferime, udhëtime, dieta	71,930	1,237,563
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime	230,012	-
Shpenzime të tjera korente	283,672	257,742
Total	771,760	1,823,270

20. Ngjarje pas datës së raportimit

Drejtimi i Shoqërisë vlerëson që pandemia COVID-19 ka impaktuar periudhat e mëpasshme të ushtrimit të aktivitetit, dhe do të vazhdoje impaktin por shoqeria nuk është në gjendje të bëjë një vlerësim paraprak të efekteve të kësaj situate.